# KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

# RAPORT MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT PËR VITIN 2023

KZHK

2023

## TABELA E PËRMBAJTJES

**I. HYRJE …………………………………………………………………………….2**

**II. MBI PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË ..........................………………...3**

**III. MBI BASHKËPUNIMIN ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS ……………..11**

**IV. MBI EMËRIMIN E MAGJISTRATËVE.....………………………………............15**

**V. MBI SKEMËN E DELEGIMIT …………………………………………………..18**

**VI. MBI KOMANDIMIN E GJYQTARËVE ……………………………………......19**

**VII. MBI TRANSFERIMIN E GJYQTARËVE ………………………........................21**

**VIII. MBI MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT …………………………..28**

**IX. MBI CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË ÇËSHTJE TË VEÇANTA …………......29**

**X. MBI ÇËSHTJE TË TJERA ……………………………………………...……...30**

**XI. PËRFUNDIME …..………………………………………………………..……...31**

**XII. PERFORMANCA E KZHK PËR PERIUDHËN PESË VJEÇARE 2019-2023.......32**

**XIII. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024……….…………………………….……..33**

## I. HYRJE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ qeverisës i gjyqësorit, ka mandatin ligjor për të "siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor". Në këtë kuadër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ushtron rolin e tij, ndër të tjera, duke përgatitur projekt vendimmarrjet ne lidhje me procesin e përzgjedhjes/emërimit, promovimit, transferimit mbi bazën e kualifikimit profesional dhe integritetit personal, edhe nëpërmjet kohëzgjatjes së ushtrimit të funksionit e sigurisë financiare, pavarësisë në vendimmarrje, si dhe garantimit të drejtave vetjake të gjyqtarit. Çdo projektvendim i paraqitur në lidhje me emërimin apo karrierën e gjyqtarëve ka qenë i bazuar në kritere objektive të përcaktuara nga ligji për statusin.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgjatë vitit 2023 ka përmbushur një sërë detyrash të rëndësishme që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij, por edhe një sërë detyrash që lidhen me prioritetet e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor (*në vijim referuar si Këshilli*).

Ky Komision është një ndër katër Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me vendimin nr.601, datë 23.12.2021, të ndryshuar me vendimin nr.79, datë 02.03.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë zgjedhur anëtarë të përhershëm të Komisionit z. Klodian Kurushi, z. Dritan Hallunaj, z. Alban Toro dhe anëtarë zëvendësues znj. Marçela Shehu dhe z. Ilir Rusi. Ky Komisionin ushtron funksionet sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit ner.115/2016 "Për organet e qeverisjes së drejtësisë", i ndryshuar. Me vendimin nr. 742, datë 26.12.2023, për shkak të përfundimit të mandatit të znj. Dritan Hallunaj dhe anëtare zëvendësues znj. Marçela Shehu, është zgjedhur anëtare e KZHK z. Markelian Koça dhe anëtar zëvendësues z. Ridvan Hado. Komisioni është asistuar përgjatë vitit 2023, nga këshilltaret ligjore znj. Maela Alicanaj dhe znj. Anisa Brano.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (*në vijim referuar si KZHK ose Komisioni*) ka pasur në fokus ndjekjen e procesit të plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, skemës së delegimit, transferimit përkohësisht të gjyqtarëve, si dhe ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga drejtuesit e gjykatave në lidhje me caktimin e gjyqtarëve të ndryshëm për shqyrtimin e çështjeve të veçanta. Gjithashtu, Komisioni ka përmbushur detyrimet ligjore në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës për caktimin e numrit të magjistratëve të rinj.

Pasur parasysh, Synimin I të Strategjisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni pati prioritet përmbylljen në një afat kohor sa më të shkurtër të pozicioneve vakante në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve. Këto pozicione të lira janë në të tre fushat e së drejtës: penale, administrative dhe civile. Në këtë mënyrë, Këshilli iu përgjigj edhe Rekomandimit nr. 1 të Rezolutës së Kuvendit për KLGJ-në. Gjithashtu, prioritet ka qenë edhe plotësimi i pozicioneve të lira pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe gjykatës së apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Përveç sa më sipër, në kushtet kur nëpër gjykatat e të gjitha niveleve vijon boshatisja për shkak të efekteve të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe ekzistojnë pengesa të ndryshme për plotësimin e tyre me gjyqtarë, Komisionit i është dashur të delegojë një numër të lartë gjyqtarësh, me qëllim zhbllokimin e situatës dhe garantimin e dhënies së drejtësisë për individët.

## II. MBI PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË

### 1. PËR GJYKATËN E LARTË

#### 1.1 Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve.

Këshilli, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji[1], në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja "a", i Kushtetutës), më parë, mbi propozimet e KZHK-së ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për tre pozicione të lira gjatë vitit 2021, nga të cilat 2 *(dy)* pozicion në fushën e të drejtës civile dhe 1 *(një)* pozicion pozicione në fushën e të drejtës administrative. Në vijim Komisioni ka hapur një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, për shkak të përfundimit të mandatit të z. Medi Bici të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.

Në përfundim të afatit të kandidimit, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli, filloi procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe përcaktimin e relatorëve përkatës për kandidatët e katër pozicioneve të shpallura me vendimet nr. 535 nr. 536 nr. 537 datë 17.11.2021 dhe nr. 178 datë 11.05.2022 gjithashtu mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli, me herët kishte filluar dhe procedurat caktimin të relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje për emërim sipas fushave të së drejtës të pozicioneve të lira të shpallura të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve.

Pas verifikimit, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli ka miratuar 1 (*një*) akt administrativ individual për kualifikimin e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet përkatëse.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për kandidatët e Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve, relatori i procedurës së përzgjedhjes, vijoi me propozimin për renditje të gjyqtarëve në Gjykatën Lartë për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 536 dhe nr. 537 datë 17.11.2021, me propozimin për renditje të gjyqtarëve në Gjykatën

[1] Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë" i ndryshuar;
Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020, "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve".

Lartë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimin nr.535 datë 17.11.2021. Pas miratimit nga Këshilli të renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe administrative, relatori i çështjes përcolli për miratim propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve Znj. Enkelejda Metaliaj, Znj. Vojsava Kola dhe z. Valbon Çekrezi.

***Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, gjatë vitit 2023, nga ku rezulton të jenë miratuar:***

- **1 (*një*)[2] akt administrativ individual** për kualifikimin e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet përkatëse;
- **3 (*tre*)[3] akte administrative kolektive** për propozimin për emërim në Gjykatën Lartë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 535, datë 17.11.2021, për propozimin për emërim në Gjykatën Lartë për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 536, nr. 537 datë 17.11.2021.
- **3 (*tre*)[4] akte administrative individuale** për miratim propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve.

***Pengesat e hasura:***

- Procesi i vlerësimit etik-profesional i kandidatëve për katër pozicionet e shpallura me vendimet nr. 535 nr. 536 nr. 537 datë 17.11.2021 dhe nr. 178 datë 11.05.2022 konsumoi një kohë relativisht të madhe;
- Aktet e miratuara nga Këshilli për propozimin për emërim u ankimuan nga gjyqtarë të përfshirë në këtë procedurë. Si pasojë procedura u shty deri në marrjen formë të prerë të këtyre vendimeve;
- Komisioni ka përfunduar detyrimet ligjore lidhur me kandidatët e përfshirë në pozicionin penal të mbetur vakant. Pritet vendimmarrja e Këshillit lidhur me kualifikimet/skualifikimet e 2(dy) kandidatëve.

[2] Vendim nr. 83 datë 16.02.2023 "Për kualifikimin e kandidatit z. Markelian Koça dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor"

[3] Vendim nr. 212 datë 28.04.2023 "Vendim paraprak – Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021"; Vendim nr. 315 datë 14.06.2023 "Vendim paraprak -Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021" ; Vendim nr. 316 datë 14.06.2023 "Vendim paraprak -Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021".

[4] Vendimi nr. 270 datë 25.05.2023 Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidates znj. Enkelejda Metaliaj;
Vendimi nr. 458 datë 25.07.2023 për propozim për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidates Vojsava Kola;
Vendimi nr. 474 datë 13.09.2023 për propozim për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit Valbon Çekrezi;

## 2. PËR GJYKATAT E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Një nga arritjet e reformës në drejtësi ishte krijimi i gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Sipas Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, për vitin 2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të: *plotësojë vendet vakante në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.* Pra, promovimi i gjyqtarëve pranë kësaj gjykate vijon të jetë një nga Rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë kishte për KLGJ-në për vitin 2023.

### 2.1 Procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 286, datë 18.12.2019, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të kësaj gjykate është 16 (*gjashtëmbëdhjetë),* ashtu siç përcakton Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", pikërisht shkronja "ç", pika 4, e nenit 15.

Përveç sa më sipër vlen të theksohet se gjatë vitit 2021 me propozim të Komisionit, Këshilli ka hapur dhe rihapur procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dymbëdhjetë pozicione të lira, për disa prej të cilave nuk u paraqit asnjë kandidaturë, për pozicion e lirë nr. 128 datë 01.04.2021, për pozicion e lirë nr. 123 datë 01.04. 2021 dhe për pozicionin e lirë nr. 287 datë 06.07.2021, Këshilli vijoi procedurën e ngritjes në detyrë për kandidatët që kandiduan.

Në vijim Komisioni përgjatë vitit 2022 hapi tre pozicione të reja të shpallura me vendimet nr. 499, nr.500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, duke përcaktuar dhe afatin dy javor të kandidimit për këto procedura ngritje në detyrë. Për pozicionet e lira sa më sipër kandiduan 14 *(katërmbëdhjetë*) kandidatë, Këshilli me vendim nr. 66* datë 09.02.2023 vijoi procedurën verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022 dhe përcaktimin e relatorëve për secilin kandidatë.

Për pozicionet e lira nr. 499, nr.500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit vijuan përgjatë vitit 2023. Mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, është vendosur nga Këshilli verifikimi i katër kritereve ligjore: i) "përvojës profesionale minimale"; ii) "dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; iii) "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe iv) "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale" për 13[5] (*trembëdhjetë*) kandidatë ndërsa pritet kualifikimi i

[5] Vendimi nr. 204, datë 26.04.2023 që i përket Diamela Goxha, Vendimi nr. 207*, datë 26.04.2023 që i përket Paulin Çera, Vendimi nr. 262*, datë 24.05.2023 që i përket Marinela Osmani, Vendimi nr. 263, datë 24.05.2023 që i përket Edvan Veçani, Vendimi nr. 264*, datë 24.05.2023 që i përket Gerd Hoxha, Vendimi

tyre i cili është i varur nga veprimtaria e Komisionit e të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve që është pjesë e strukturës së Institucioneve që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar. Bazuar në nenin 6 dhe nenin 57 pika 11 të Ligjit të ligjit 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës ushtron funksionet dhe veprimtarinë e tij verifikuese pranë Institucioneve që luftojnë Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Rrjedhimisht procesi i verifikimit të pasurisë dhe të figurës për kandidatët që kërkojnë të ngrihen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar do të realizohet nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve.

Ndërkohë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gj në Gjykatën e Posaçme të shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pati edhe tërheqje nga kandidimi, e për rrjedhojë, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli ka miratuar 1 (*një)*[6] vendim për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të kandidates, në pozicionet respektive ku kishte kandiduar.

Për 1 (*një*)[7] kandidate të procedurave të shpallura për vitin 2021, që kaloi me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, është administruar informacioni nga institucionet përkatëse dhe, mbi propozimin e relatorëve anëtarë të KZHK-së, është vendosur nga Këshilli kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar sipas pozicionit përkatës ku kishte kandiduar.

Referuar proceduarve të mëhershme për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar vendimin nr.372 datë 13.07.2023 për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.7.2021 si dhe caktimin e relatorit.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për kandidatët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, relatori i procedurës së përzgjedhjes, vijoi me propozimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendim nr. 128 datë 01.04.2021, për pozicion e lirë nr. 123 datë 01.04. 2021 dhe për pozicionin e lirë nr. 287 datë 06.07.2021[8]. Pas miratimit nga Këshilli të

nr. 265*, datë 24.05.2023 që i përket Arbër Çela, Vendimi nr. 266, datë 24.05.2023 që i përket Besmir Stroka, Vendimi nr. 268*, datë 24.05.2023 që i përket Matilda Fetau, Vendimi nr. 293*, datë 30.05.2023 që i përket Laurent Fuçia, Vendimi nr. 310, datë 06.06.2023 që i përket Alma Kodraliu, Vendimi nr. 311, datë 06.06.2023 që i përket Alma Kolgjoka, Vendimi nr. 312, datë 06.06.2023 që i përket Nurjeta Pogaçe, Vendimi nr. 313*, datë 06.06.2023 që i përket Oltjona Goxha.

[6] Vendimi nr. 124, datë 15.03.2023 që i përket kandidates Yrfet Shkreli.

[7] Vendimi nr. 359, datë 13.07.2023 që i përket kandidates Elsa Ulliri;

[8] Vendim nr.363 datë 13.07.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021,"; Vendim nr.380 datë 17.07.2023 "Për renditjen e

renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në rastin konkret kandidatë të vetëm për këtë pozicion) relatori i çështjes përcolli për miratim propozimin për ngritje në detyrë në Gjykatën në Gjykatën e Posaçme të shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për gjyqtaren znj. Elsa Ulliri , znj. Rudina Palloj dhe znj. Atalanta Zeqiraj[9].

***Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjatë vitit 2023, nga ku rezulton se janë miratuar:***

- **1* (*një*) akt administrativ kolektiv** për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- **14 (*katërmbëdhjetë*) akte administrative individuale,** nga të cilat 13* (*trembëdhjetë*) për verifikimin e plotësimit të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 1 (*një*) për kualifikimin e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- **1 *(një)* akt administrativ individual** për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi në pozicionet përkatëse.

- **1 (*një*) akt administrativ kolektiv,** për përzgjedhjen për ngritjen në detyrë të kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- **3 (*tre*) akte administrative kolektive** për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- **3 (*tre*) akte administrative individuale,** për ngritjen në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

---

kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021"; Vendim nr.635 datë 19.10.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021"

[9] Vendim nr.373 datë 13.07.2023 "Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. Atalanta Zeqiraj"; Vendim nr. 389 datë 17.07.2023 "Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. Elsa Ulliri"; Vendim nr.636 datë 19.10.2023 "Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. Rudina Palloj".

***Pengesat e hasura:***

- Procesi i verifikimit të pasurisë dhe të figurës për kandidatët që kërkojnë të ngrihen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në bazë të ligjit realizohet nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, që ushtron funksionet dhe veprimtarinë e tij verifikuese pranë Institucioneve që luftojnë Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- Procesi i verifikimit të pasurisë e figurës për këta kandidatë, është një ndër kushtet e nevojshme për kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurës së mëtejshme nga ana e Komisionit. Ky proces i cili nuk është përfunduar ende nga Komisioni i Posaçëm ka ndikuar në kohëzgjatjen e kësaj procedure.

## 3. PËR GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3, të nenit 8, në shkronjën "a", të pikës 1 dhe në pikën 4, të nenit 47, në pikën 2, në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin si dhe në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 61, në shkronjën "ç", të nenit 86 dhe në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe pas plotësimit të kuadrit të plotë ligjor për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, me propozim të KZHK-së, përgjatë vitin 2022 ka hapur 3 (tre) procedura për ngritjes në detyrë pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në fushën e të drejtës penale, me vendimet nr.502, nr.503 nr.504 datë 21.11.2022. Afati i kandidimit për të gjitha këto pozicione të lira, ishte dy javë nga data e shpalljes së vendimit. Brenda afatit të kandidimit për këto pozicione të lira, kandiduan 22 (*njëzet e dy*) kandidatë, për 3 (*tre*) nga pozicionet e lira. Pas përfundimit të afatit të kandidimit, me vendimin nr. 66 datë 09.02.2023 është vendosur nga Këshilli fillimi i procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë dhe caktimi me short i relatorëve për secilin kandidat.

Në vijim Komisioni përgjatë vitit 2023 hapi 9 (nëntë) procedura të reja për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në fushën e të drejtës civile. Për këto pozicione të reja të shpallura me vendimet nr. 239- nr.247 datë 24.05.2023, është përcaktuar dhe afati tre javor i kandidimit. Për pozicionet e lira sa më sipër kandiduan 30 *(tridhjetë)* kandidatë, gjithashtu Komisioni hapi 4 (katër) procedura të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, pozicione të reja të shpallura me vendimet nr. 235- nr.238 datë 24.05.2023, duke përcaktuar edhe afatin tre javor të kandidimit për këto procedura ngritje në detyrë. Për pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit kandiduan 11 *(njëmbëdhjetë)* kandidatë.

[10]Vlen të theksohet se KZHK-ja më herët kishte hapur procedurat e ngritjes në detyrë pranë gjykatës të apelit të juridiksionit të përgjithshëm për 4 (*katër*) pozicione të lira, të shpallura me vendimet nr.183 nr.184, nr.185 datë 28.05.2020 si dhe nr. 129 datë 01.04.2021; dhe Gjykatës Administrative të Apelit, me vendimet nr.290 datë 06.07.2021 dhe nr.571 datë 07.12.2021. Për pozicionet e lira, procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit vijuan përgjatë vitit 2023.

Për të gjitha pozicionet e hapura përgjatë vitit 2022 mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, është vendosur nga Këshilli, verifikimi i tre kritereve [11] ligjore (i) *"përvojës profesionale minimale*"[12]; ii) "*mospasjes masë disiplinore në fuqi*"; dhe iii) "*mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale"*) dhe kualifikimi[13] i tyre, si dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm/Gjykatën Administrative të Apelit, sipas pozicionit përkatës ku kishin kandiduar.

Ndërkohë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm/Gjykatën Administrative të Apelit, pati edhe tërheqje nga kandidimi nga disa kandidatë, e për rrjedhojë, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli ka miratuar 7 (*shtatë) [14]* vendime për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të kandidatëve, në pozicionet respektive ku ata kishin kandiduar.

---

[10] Referuar vendimit nr.86 datë 23.02.2023 Për miratimin e "Për miratimin e "Raport mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për vitin 2022"

[11] Vendimi nr. 177, datë 25.04.2023 që i përket Esmeralda Xhili, Vendimi nr. 178, datë 25.04.2023 që i përket Engjëllushe Tahiri, Vendimi nr. 182, datë 25.04.2023 që i përket Ardit Mustafaj, Vendimi nr. 183, datë 25.04.2023 që i përket Niko Rapi, Vendimi nr. 184, datë 25.04.2023 që i përket Artan Çupi, Vendimi nr. 205, datë 26.04.2023 që i përket Matilda Llangozi, Vendimi nr. 206, datë 26.04.2023 që i përket Olkeda Lice, Vendimi nr. 207, datë 26.04.2023 që i përket Paulin Çera, Vendimi nr. 208, datë 26.04.2023 që i përket Adelajda Gjuzi, Vendimi nr. 209, datë 26.04.2023 që i përket Artan Jahollari, Vendimi nr. 262, datë 24.05.2023 që i përket Marinela Osmani, Vendimi nr. 263, datë 24.05.2023 që i përket Edvan Veçani, Vendimi nr. 264, datë 24.05.2023 që i përket Gerd Hoxha, Vendimi nr. 265, datë 24.05.2023 që i përket Arber Çela, Vendimi nr. 266, datë 24.05.2023 që i përket Besmir Stroka, Vendimi nr. 267, datë 24.05.2023 që i përket Aurel Arapi, Vendimi nr. 268, datë 24.05.2023 që i përket Matilda Fetau, Vendimi nr. 274, datë 25.05.2023 që i përket Elvana Çiçolli, Vendimi nr. 293, datë 30.05.2023 që i përket Laurent Fuçia, Vendimi nr. 313, datë 06.06.2023 që i përket Oltjona Goxhaj.

[12] Në rastin e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: *"Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar".*

[13] Vendimi nr. 70, datë 09.02.2023 që i përket kandidates Enerjeta Shehaj, Vendimi nr. 279, datë 25.05.2023 që i përket Esmeralda Xhili, Vendimi nr. 280, datë 25.05.2023 që i përket Olkeda Lice, Vendimi nr. 281, datë 25.05.2023 që i përket Artan Jahollari, Vendimi nr. 282, datë 25.05.2023 që i përket Adelajda Gjuzi, Vendimi nr. 283, datë 25.05.2023 që i përket Ardit Mustafaj, Vendimi nr. 290, datë 30.05.2023 që i përket Niko Rapi, Vendimi nr. 291, datë 30.05.2023 që i përket PAulin Çera, Vendimi nr. 292, datë 30.05.2023 që i përket Artan Çupi, Vendimi nr. 329, datë 14.06.2023 që i përket Aurel Arapi, Vendimi nr. 336, datë 21.06.2023 që i përket Marinela Osmani, Vendimi nr. 357, datë 06.07.2023 që i përket Oltjona Goxhaj, Vendimi nr. 379, datë 17.07.2023 që i përket Matilda Fetau, Vendimi nr. 483, datë 13.09.2023 që i përket Engjëllushe Tahiri, Vendimi nr. 506, datë 28.09.2023 që i përket Gerd Hoxha, Vendimi nr. 507, datë 28.09.2023 që i përket Elvana Çiçolli.

[14] Vendimi nr. 122, datë 15.03.2023 që i përket Anila Guri, Vendimi nr. 123, datë 15.03.2023 që i përket Armela Hasantari, Vendimi nr. 143, datë 28.03.2023 që i përket Besjana Garxenaj, Vendimi nr. 287, datë 29.05.2023 që i përket Sokol Ibi, Vendimi nr. 347, datë 06.07.2023 që i përket Elvana Çiçolli, Vendimi nr. 492, datë 21.09.2023 që i përket Matilda Llangozi, Vendimi nr. 503, datë 28.09.2023 që i përket Gerd Hoxha.

Komisioni i ka propozuar KLGJ-së miratimin e projektvendimit në lidhje me fillimin e procedurave të përzgjedhjes[15]për ngritjen ne detyre në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, të shpallura me Vendimet e Këshillit vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, si dhe caktimin e relatorit.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për kandidatët e gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm/Gjykatën Administrative të Apelit nga radhët e gjyqtareve, relatori i procedurës së përzgjedhjes, vijoi me propozimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe dy pozicione ne fushën e të drejtës penale, në Gjykatën e Apelit si dhe për dy pozicione të lira, në Gjykatën Administrative të Apelit,[16]. Pas miratimit nga Këshilli të renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale dhe civile, relatori i çështjes përcolli për miratim propozimin për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. Marsela Pepi, znj. Alma Kolgjoka, z. Qemal Zaimi si dhe për ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit znj. Enerjeta Shehaj dhe znj. Rezarta Aliu[17].

Vlen të theksohet se është ende në procedurë verifikimi i kritereve formale për 13(trembëdhjetë) pozicione në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm/administrativ.

---

[15]Vendim nr.334 , datë 21.06.2023 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022".

[16] Vendim nr.68 datë 09.02.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021"; Vendim nr.231 datë 11.05.2023" Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021,"; Vendim nr.515 datë 05.10.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020"; Vendim nr.516 datë 05.10.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020" ;Vendim nr.633 datë 19.10.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020".

[17] Vendim nr.90 datë 23.02.2023 "Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. Rezarta Aliu"; Vendim nr.288 datë 29.05.2023 "Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. Enerjeta Shehaj"; Vendim nr.583 datë 18.10.2023 "Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. Marsela Pepi; Vendim nr.585 datë 18.10.2023 "Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. Qemal Zaimi, ; Vendim nr.634 datë 19.10.2023 "Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të znj. Alma Kolgjoka.

***<u>Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit gjatë vitit 2023, nga ku rezulton se janë miratuar:</u>***

- **13 (*trembëdhjetë*) akte administrative kolektive** akte për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;
- **1 *(një*) akt administrativ kolektiv** për fillimin e procedurave të verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- **34 (*tridhjetë e katër*) akte administrative individuale** nga të cilat 18 (*tetëmbëdhjetë*) për verifikimin e plotësimit të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 16 (*gjashtëmbëdhjetë*) për kualifikimin e kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;
- **7 *(shtatë*) akte administrative individuale** për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi në pozicionet përkatëse.
- **5 *(pesë*) akte administrative individuale** nga të cilat 3 (*tre*) akte janë për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe 2 (*dy*) akt për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit.
- **1 (*një*) akt administrativ kolektiv** për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- **5 *(pesë*) akte administrative individuale** nga të cilat 3 (*tre*) akte janë për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe 2 (*dy*) akte për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit.

***<u>Pengesat e hasura:</u>***

- Procedurat e Komisionit për renditjen e kandidatëve janë të ndërvarura nga puna e Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale dhe vonesat e këtij Komisioni reflektojnë dhe ndikojnë në veprimtarinë e KZHK-së për mbylljen me sukses të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit.

## III. MBI BASHKËPUNIMIN ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

### 3.1 Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës në kuadër të përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024

Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 29, të Ligjit për Statusin në janar të çdo viti, Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë (*profili gjyqtar*) që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik. Krahas kësaj, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 53, të Ligjit nr. 98/2016, "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë edhe numrin maksimal të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

Nisur nga këto detyrime ligjore, Këshillit i duhej që, brenda janarit 2023, të përcaktonte numrin maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që duhet të pranoheshin në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin e ri akademik 2023-2024. Për këtë qëllim, Komisioni ka përgatitur Projektvendimin *"Për numrin maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që duhet të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin e ri akademik 2023-2024",* duke marrë në analizë një sërë treguesish dhe faktorësh të rëndësishëm që lidheshin me këtë proces të rëndësishëm[18].

Mbi propozimin e Komisionit, Këshilli ka miratuar Vendimin nr. 55, datë 31.01.2023 "*Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024",* në përmbajtjen e të cilit u përcaktua: (i) Numri i kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, do të jetë 40 (*dyzet); (ii)* Numri i kandidatëve për ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, është 15 (pesëmbëdhjetë) kandidatë ndihmës ligjorë.

Në kuadër të këtij procesi, është miratuar Vendimi nr.67 datë 09.02.2023 *"Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024*", i cili verifikoi plotësimin e kritereve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatëve për ndihmës ligjorë.

***Përfundime në lidhje me bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës në kuadër të përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë dhe për ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024 nga ku rezulton se janë miratuar:***

- **1 *(një*) akt administrativ kolektiv** mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024

;[18] Këta tregues dhe faktorë lidheshin me situatën në të cilën ishte sistemi gjyqësor, me ndikimin që ka në sistemin gjyqësor implementimi i reformës në drejtësi, me kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës në lidhje me ofrimin e formimit fillestar, të vlerësuara në harmoni me projeksionin/vizionin e Këshillit për sistemin gjyqësor në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

**3.2 Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës në kuadër të verifikimit të kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës**

Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës ka ndërmarrë procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2023-2024, sipas përcaktimeve ligjore, gjithsej për 40 (*dyzet*) kandidatë.

Menjëherë, mbi propozimin e KZHK-së, me Vendimin nr. 375, datë 13.07.2023, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024.

Megjithatë, procesi hasi në vështirësi për shkak se një pjesë e periudhës së verifikimit koincidoi me muajin gusht, gjatë të cilit subjektet publike dhe private funksionojnë me personel të reduktuar për shkak të kryerjes nga punonjësit të pushimeve vjetore, çka solli vonesa të dërgimit të informacioneve dhe raportimeve të kërkuara nga Këshilli.

Për rrjedhojë, Këshilli në Mbledhjet Plenare të datës 26.10.2023, datës 08.11.2023, të datës 21.11.2023 si dhe të datës 06.12.2023, të datës 07.12.2023 në Mbledhjen Plenare, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, ka kualifikuar 30 *(tridhjetë*)[19] kandidatë për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar.

Dy kandidatët e formimit fillestar për vitin akademik 2021-2022[20], procedura e të cilëve u zgjat në kohë në kuadër të verifikimit të figurës, nga të cilët një kandidat u kualifikua nga Këshilli në mbledhjen plenare të datës 05.06.2023 dhe një kandidat u skualifikua nga Këshilli në mbledhjen plenare të datës 12.10.2023, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së.

---

- 8 (*tetë*)[41] **akte administrative individuale**, për transferimin e gjyqtarë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

### 7.3 Transferimi i përhershëm i gjyqtarëve nëpërmjet "procedurës së lëvizjes paralele" sipas nenit 43 të Ligjit për Statusin.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgjatë vitit 2023 në kohë të ndryshme ka vlerësuar t'i propozojë Këshillit, mjetet efikase dhe ligjore që do të mund të stabilizojnë funksionalitetin e cenuar të disa Gjykatave me qëllim që të parandalohet cenimi i mëtejshëm i funksionalitetit të tyre duke përfshirë edhe efektet që rrjedhin nga aplikimi i Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" duke krijuar vakancave të përkohshme dhe të përhershme.

Një nga mekanizmat që Komisioni ka përdorur për këtë qëllim ka qenë zhvillim i procesit të lëvizjes paralele, si një nga format e transferimit të magjistratit, duke parashikuar rregulla[42] që adresojnë si nevojat e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe të drejtën e magjistratit për ecurinë në karrierë. Bazuar në parimet e parashikuara në nenin 42, ligjvënësi ka synuar që nëpërmjet rregullave kryesisht procedurale në nenin 43, të garantojë qartësi dhe parashikueshmëri për transferimin e magjistratit në procedurën e lëvizjes paralele, si një nga mjetet standarde të lëvizjes së gjyqtarëve brenda të të njëjtit nivel.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja "a", nenin 86, shkronja "ç" dhe nenin 97, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", i ndryshuar, në Kreun IV, Seksioni A, pikat 7-11, të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, "*Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve*", me propozim të Komisionit ka vendosur hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 10[43] (*dhjetë*) pozicione të

---

[41] Vendimi nr. 57, datë 31.01.2023 "Për transferimin e gjyqtares Gilda Hoxha, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale"; Vendimi nr. 58, datë 31.01.2023 "Për transferimin e gjyqtares Lorena Çabej, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale"; Vendimi nr. 59, datë 31.01.2023 "Për transferimin e gjyqtares Marçela Shehu, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale"; Vendimi nr. 110, datë 13.03.2023 "Për transferimin e gjyqtarit z. Ardit Mustafaj, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale"; Vendimi nr. 218, datë 28.04.2023 "Për transferimin e gjyqtares Diamela Goxha, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile"; Vendimi nr. 219, datë 28.04.2023 "Për transferimin e gjyqtares Yrfet Shkreli, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan"; Vendimi nr. 220, datë 28.04.2023 "Për transferimin e gjyqtarit Gentian Marku, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë"; Vendimi nr. 221, datë 28.04.2023 "Për transferimin e gjyqtares Flutura Hoxha, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë".

[42] *Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020, "Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve".*

[43] Vendim nr. 11- nr.20 datë 18.01.2023 "Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile"

lira në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; për 4[44] (*katër*) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; për 4[45] (*katër*) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe për 2[46] (*dy*) pozicione të lira në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; për 2[47] (*dy*) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, si dhe për 3[48] (*tre*) pozicione të lira në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Afati i kandidimit për të gjitha këto pozicione të lira, ishte dy/tre javë nga data e shpalljes së vendimit. Brenda afatit të kandidimit për këto pozicione të lira, kandiduan 40 *(dyzetë)* kandidatë, për 25 *(njëzet e pesë*) nga pozicionet e lira.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 13/2023 dhe 17/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, që kanë ose mund të kenë një vlerësim, që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, referuar rregullave dhe tabelës se mësipërme për procedurën e lëvizjes paralele, KZHK përgatit në kohë të ndryshme relacionet mbi projektvendimin për "*Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele...etj*[49]." për caktimin e shortit për relatorët për secilin kandidat.

---

[44] Vendim nr. 21- nr.24 datë 18.01.2023 "Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile"
[45] Vendim nr. 248- nr.251 datë 24.05.2023 "Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile"
[46] Vendim nr. 252- nr.253 datë 24.05.2023 "Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale"
[47]Vendim nr. 254- nr.255 datë 24.05.2023 " Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile
[48] Vendim nr. 256- nr.258 datë 24.05.2023 "Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë"
[49] Vendim nr. 115 datë 13.03.2023 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor" ; Vendim nr. 295 datë 30.05.2023 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim"; Vendim nr. 342 datë 27.06.2023 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim"; Vendim nr. 374 datë 13.07.2023 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, të

Mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, është vendosur nga Këshilli verifikimi i tre kritereve ligjore "përvojës profesionale minimale", të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale" dhe kualifikimi[50] i tyre, si dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele, sipas gjykatës dhe pozicionit përkatës ku kishin kandiduar.

Ndërkohë, në procedurat e lëvizjes paralele, pati edhe tërheqje nga kandidimi nga disa kandidatë, e për rrjedhojë, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli ka miratuar 15 (*pesëmbëdhjetë)*[51] vendime për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele të kandidatëve, në pozicionet respektive ku ata kishin kandiduar.

Komisioni i ka propozuar KLGJ-së miratimin e projektvendimit në lidhje me fillimin e procedurave të përzgjedhjes[52]për procedurën e lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë

---

shpallura me vendimet nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim"; Vendim nr. 385 datë 17.07.2023 "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan e Lezhë të shpallura me vendimet nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor".

[50] Vendimi nr. 179, datë 25.04.2023 që i përket kandidates Olkeda Lice; Vendimi nr. 180, datë 25.04.2023 që i përket kandidates Matilda Llangozi; Vendimi nr. 181, datë 25.04.2023 që i përket kandidatit Artan Çupi; Vendimi nr. 185, datë 25.04.2023 që i përket kandidates Nertila Kape; Vendimi nr. 186, datë 25.04.2023 që i përket kandidatit Edvan Veçani; Vendimi nr. 187, datë 25.04.2023 që i përket kandidates Adelajda Gjuzi; Vendimi nr. 188, datë 25.04.2023 që i përket kandidatit Gentian Marku; Vendimi nr. 200, datë 26.04.2023 që i përket kandidatit Taulant Banushi; Vendimi nr. 201, datë 26.04.2023 që i përket kandidatit Artan Hajredinaj; Vendimi nr. 202, datë 26.04.2023 që i përket kandidatit Aurel Arapi; Vendimi nr. 203, datë 26.04.2023 që i përket kandidates Esmeralda Xhili; Vendimi nr. 273, datë 25.05.2023 që i përket kandidatit Artan Jahollari; Vendimi nr. 332, datë 21.06.2023 që i përket kandidatit Olti Skrame; Vendimi nr. 333, datë 21.06.2023 që i përket kandidates Suela Xhani; Vendimi nr. 351, datë 06.07.2023 që i përket kandidates Yrfet Shkreli; dimi nr. 352, datë 06.07.2023 që i përket kandidatit Ardit Kuka; Vendimi nr. 386, datë 17.07.2023 që i përket kandidates Kostandina Kuro; Vendimi nr. 387, datë 17.07.2023 që i përket kandidatit Xhevdet Lika; Vendimi nr. 388, datë 17.07.2023 që i përket kandidates Entela Gjoni; Vendimi nr. 448, datë 24.07.2023 që i përket kandidates Amarilda Sulaj; Vendimi nr. 449, datë 24.07.2023 që i përket kandidatit Ervin Sulaj; Vendimi nr. 450, datë 24.07.2023 që i përket kandidatit Artur Prenga; Vendimi nr. 451, datë 24.07.2023 që i përket kandidates Thomaidha Roça; Vendimi nr. 452, datë 24.07.2023 që i përket kandidatit Gjergji Baçi; Vendimi nr. 463, datë 25.07.2023 që i përket kandidatit Ardit Kuka; Vendimi nr. 464, datë 25.07.2023 që i përket kandidates Kostandina Kuro; Vendimi nr. 465, datë 25.07.2023 që i përket kandidates Suela Lika; Vendimi nr. 499, datë 28.09.2023 që i përket kandidatit Arben Dosti; Vendimi nr. 500, datë 28.09.2023 që i përket kandidates Suela Dashi; Vendimi nr. 521, datë 05.10.2023 që i përket kandidates Ina Hoxhaj.

[51] Vendimi nr. 189, datë 25.04.2023 që i përket kandidatit Vladimir Skënderi; Vendimi nr. 308, datë 06.06.2023 që i përket kandidates Adelajda Gjuzi; Vendimi nr. 309, datë 06.06.2023 që i përket kandidatit Edvan Veçani; Vendimi nr. 317, datë 14.06.2023 që i përket kandidatit Artan Jahollari; Vendimi nr. 330, datë 21.06.2023 që i përket kandidates Nertila Kape; Vendimi nr. 331, datë 21.06.2023 që i përket kandidates Suela Xhani; Vendimi nr. 343, datë 27.06.2023 që i përket kandidatit Aurel Arapi; Vendimi nr. 344, datë 27.06.2023 që i përket kandidatit Taulant Banushi; Vendimi nr. 345, datë 27.06.2023 që i përket kandidates Matilda Llangozi; Vendimi nr. 383, datë 17.07.2023 që i përket kandidatit Artan Hajredinaj; Vendimi nr. 384, datë 17.07.2023 që i përket kandidates Olkeda Lice; Vendimi nr. 431, datë 18.07.2023 që i përket kandidatit Artan Hajredinaj; Vendimi nr. 488, datë 21.09.2023 që i përket kandidates Thomaidha Roça; Vendimi nr. 517, datë 05.10.2023 që i përket kandidates Thomaidha Roça; Vendimi nr. 276, datë 25.05.2023 që i përket kandidates Diamela Goxha;

[52]Vendim nr.294, datë 30.05.2023 "Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e

të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe caktimin e relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje për transferim sipas fushave të së drejtës të pozicioneve të lira të shpallura.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për kandidatët e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, relatori i procedurës së përzgjedhjes, vijoi me propozimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele, për 16 pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Tiranë dhe Durrës[53]. Pas miratimit nga Këshilli të renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, Durrës, Tiranë dhe Elbasan, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale dhe civile, relatori i çështjes përcolli për miratim propozimin për transferimin e gjyqtarit për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë z. Edvan Veçani, znj. Esmeralda Xhili, z. Gentian Marku, z. Artan Hajredinaj, znj. Matilda Llangozi, znj. Nertila Kape dhe znj, Amarilda Sulaj; për transferimin e gjyqtarit për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës znj. Kostandina Kuro dhe për transferimin e gjyqtarit për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatën e

---

shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor"; Vendim nr.468, datë 25.07.2023 "Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor".

[53] Vendim nr.382 datë 17.07.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023"; Vendim nr.434 datë 18.07.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 12, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor"; Vendim nr.435 datë 18.07.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023"; Vendim nr.467 datë 25.07.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023"; Vendim nr.478 datë 13.09.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023"; Vendim nr.489 datë 21.09.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 248 datë 24.05.2023"; Vendim nr.490 datë 21.09.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 250 datë 24.05.2023"; Vendim nr.491 datë 21.09.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023"; Vendim nr.494 datë 21.09.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 20, datë 18.01.2023"; Vendim nr.510 datë 05.10.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 17, datë 18.01.2023"; Vendim nr.587 datë 18.10.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023"; Vendim nr.589 datë 18.10.2023 "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023".

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga, z. Gjergji Baçi dhe znj. Thomaidha Roça.

Procedura e lëvizjes paralele vijon për 8 (tetë) pozicione në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 3 (tre) pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

***<u>Përfundime në lidhje me procedurat e lëvizjes paralel në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm gjatë vitit 2023, nga ku rezulton se janë miratuar:</u>***

- **25 (*njëzet e pesë*) akte administrative kolektive** akte për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- **5 (*pesë*) akt administrativ kolektiv** për fillimin e procedurave të verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për procedurës së lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- **30 (*tridhjetë*) akte administrative individuale** për kualifikimin e kandidatëve në procedurat e lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- **15 (*pesëmbëdhjetë*) akte administrative individuale** për përfundimin e procedurave të lëvizjes paralele, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi në pozicionet përkatëse.
- **2 (*dy*) akte administrative kolektive** për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.
- **12 (*dymbëdhjetë*) akte administrative individuale** janë për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm
- **11 (*njëmbëdhjetë*) akte administrative individuale** janë për transferimin e gjyqtareve për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

***<u>Pengesat e hasura:</u>***.

- Ky proces është zgjatur në kohë pasi ai është i ndërvarur nga puna e Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale dhe vonesat e këtij Komisioni reflektojnë dhe ndikojnë së tepërmi në veprimtarinë e KZHK-së për mbylljen me sukses të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele.

## VIII. MBI MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT

Neni 65[54] i Ligjit për Statusin parashikon mundësinë e mbarimit të statusit të gjyqtarit, për shkak të paraqitjes së dorëheqjes pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose për shkak të mbushjes së moshës së pensionit/pension të parakohshëm. Mbarimi i statusit të magjistratit në këto raste deklarohet me vendim të Këshillit.

Gjatë vitit 2023 janë propozuar nga KZHK-ja 6 (*gjashtë*) akte administrative individuale për mbarimin e statusit të gjyqtarëve të niveleve të ndryshme. Në 4 (katër) raste për shkak mbushjes së moshës së pensionit dhe në 2(dy) raste për shkak të paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit të Lartë Gjyqësor. Të gjitha këto propozime janë miratuar nga Këshilli, duke krijuar në këtë mënyrë 6 pozicione të tjera të lira të përhershme në gjykatat shqiptare.

***<u>Përfundime në lidhje me dorëheqjet e paraqitura nga gjyqtarët përgjatë vitit 2023, nga ku rezulton se janë miratuar:</u>***

- **6 (*gjashtë*)[55] akte administrative individuale** për mbarimin e statusit të gjyqtarëve për shkak të paraqitjes së dorëheqjes dhe për miratimin e pensionit të parakohshëm/moshës së pensionit.

## IX. MBI CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË ÇËSHTJE TË VEÇANTA

Komisioni në vitin 2023, bazuar në vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", (i ndryshuar), ka trajtuar **169** (*njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë)* kërkesa për caktim gjyqtari nga kryetarët respektiv të gjykatave me motivacionin se janë në pamundësi për shqyrtimin e tyre, nga të cilat:

- 139 kërkesa të ardhura nga gjykatat e rretheve gjyqësore (përfshirë edhe gjykatën e posaçme të shkallës së parë);
- 25 kërkesa të ardhura nga gjykatat administrative (përfshirë edhe apelin administrativ); si dhe
- 5 kërkesa të ardhura nga gjykatat e apeleve (përfshirë edhe gjykatën e posaçme të apelit).

---

[54] Neni 65 i Ligjit për Statusin përcakton se: "*1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni*".

[55] Vendimi nr. 69, datë 09.02.2023 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Hasan Selimi, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër"; Vendimi nr. 111, datë 13.03.2023 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Ded Miri, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin"; Vendimi nr. 227, datë 08.05.2023 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë z. Arben Mickaj. Vendimi nr. 318, datë 14.06.2023 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Petraq Çuri, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës"; Vendimi nr. 453, datë 24.07.2023 "Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit për z. Murat Lleshi, gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër"; Vendimi nr. 639, datë 26.10.2023 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren znj. Afërdita Maho".

Në përgjigje të këtyre kërkesave, mbi propozimet e KZHK-së dhe pas procedurave të shortit elektronik, janë caktuar **208** (*dyqind e tetë*) gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, nga të cilët:

- 178 gjyqtarë nga gjykatat e rretheve gjyqësore (përfshirë gjykata e posaçme e shkallës së parë);
- 25 nga gjykatat administrative (përfshirë edhe apelin administrativ); si dhe
- 5 nga gjykatat e apeleve (përfshirë edhe gjykatën e posaçme të apelit).

***<u>Përfundime në lidhje me trajtimin e kërkesave për caktim gjyqtari përgjatë vitit 2023, nga ku rezulton se janë miratuar:</u>***

- **31 (*tridhjetë e një*) akte administrative kolektive gjithsej**; nga të cilat **26 (*gjashtëdhjetë e gjashtë*) akte administrative nëpërmjet të cilave janë trajtuar 169** (*njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë)* kërkesa për caktim gjyqtari dhe në përgjigje të tyre janë caktuar **208** (dyqind e tetë) gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme;
- **1 (*një*) akt mbi ndryshimin e pjesshëm të akteve;**
- **4 (*katër*) akte** lidhur me kërkesa të tjera të paraqitura pranë Komisionit.

Vlen të theksohet se përgjatë vitit 2023 kur implementimi i hartës gjyqësore është bërë aktiv, numri i kërkesave për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, ka rënë ndjeshëm.

## X. MBI ÇËSHTJE TË TJERA

Përveç sa më sipër, KZHK-ja ka trajtuar si dhe ka kaluar për shqyrtim në Këshill edhe disa çështje të tjera që lidhen me fushën e veprimtarisë së tij, për të cilat Këshilli ka miratuar 4 (*katër)*[56] vendimmarrje.

Gjithashtu, nga ana e KZHK-së janë trajtuar edhe një sërë kërkesash të gjyqtarëve dhe institucioneve të ndryshme lidhur me çështje të cilat përfshihen në veprimtarinë e KZHK-së, për të cilat është hartuar kthim përgjigje apo adresuar për zgjidhje problematika e bërë prezent.

---

[56] Vendimi nr.86 , datë 23.02.2023 "Për miratimin e "Raport mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për vitin 2022"; Vendimi nr.485 , datë 21.09.2023 "Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë"; Vendimi nr.663 , datë 02.11.2023 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së znj. Ariana Gaçi"; Vendimi nr.664 , datë 02.11.2023 "Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. Sami Ujkashi"

## XI. PËRFUNDIME

**Gjatë vitit 2023, mbi projektvendime të propozuara nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar gjithsej 484 vendime, nga të cilat:**

- **88 vendime në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit** (7 vendimmarrje në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, 15 vendimmarrje në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatën e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe 66 vendimmarrje në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit);
- **1 vendim në kuadër të procedurës së përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024;**
- **6 vendime në kuadër të procedurave të mbarimit të statusit të magjistratit (për shkak pensioni ose dorëheqje);**
- **28 vendime në kuadër të procedurave të komandimit të gjyqtarëve;**
- **16 vendime në kuadër të procedurave të skemës së delegimit të ngritur pranë Këshillit sipas nenit 45 të Ligjit për Statusin;**
- **146 vendime në kuadër të procedurave të transferimit të përkohshëm dhe të përhershme të gjyqtarëve** (30 vendimet janë sipas nenit 46 të Ligjit për Statusin); (100 vendimet janë sipas nenit 43 të Ligjit për Statusin) dhe (16 vendimet janë sipas nenit 42 të Ligjit për Statusin).
- **126 vendime në kuadër të procedurave të emërimit të magjistratëve**;
- **38 vendime në kuadër të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve të kandidimit për në formimin fillestar, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës** (në lidhje me kandidatët e shpallur fitues për vitin akademik 2021-2022; 2022-2023 dhe në lidhje me kandidatët e shpallur fitues për vitin akademik 2023-2024;
- **31 vendime në kuadër të procedurave të caktimit të gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, nga të cilat 27 vendime nëpërmjet të cilave janë trajtuar 169** kërkesa për caktim gjyqtari dhe në përgjigje të tyre janë caktuar **208** gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, si **dhe 4 vendime për çështje të tjera në kuadër të caktimit të gjyqtarëve në çështje të veçanta.**
- **4 vendime në kuadër të procedurave të tjera të lidhura me statusin dhe karrierën gjyqësore. Në këtë kategori përfshihet përmbushja e një ndër prioriteteve të Komisionit për vitin 2023, e cila lidhet me hartimin e rregullave të detajuara për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.**

## XII. PERFORMANCA E KZHK PËR PERIUDHËN PESË VJEÇARE 2019-2023

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgjatë periudhës pesë vjeçare (2019-2023) ka përmbushur një sërë detyrash të rëndësishme që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij, por edhe një sërë detyrash që lidhen me prioritetet e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (KZHK) në fokus të veprimtarisë së tij ka pasur shqyrtimin e kërkesave për emërime në gjykata duke paraqitur para Këshillit raportin përkatës shoqëruar me tabelat dhe listën e kandidatëve të pikëzuar, ndjekjen e procesit të plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes skemës së delegimit, transferimit të gjyqtarëve, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë, si dhe shqyrton kërkesat për kandidim në funksione drejtuese në gjykata. Përveç sa sipër, në kushtet kur nëpër gjykatat e të gjitha niveleve vijonte boshatisja për shkak të efekteve të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe ekzistonin pengesa të ndryshme për plotësimin e tyre me gjyqtarë, Komisionit i është dashur të delegojë një numër të lartë gjyqtarësh, me qëllim zhbllokimin e situatës dhe garantimin e dhënies së drejtësisë për individët. Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar kërkesat e Shkollës së Magjistraturës për numrin e magjistratëve të rinj, emërimin dhe caktimin në pozicion të kandidatëve të diplomuar

Angazhimi i KZHK-së për shkak të fushës së veprimtarisë që mbulon ka qenë sa i domosdoshëm aq edhe i vështirë. Domosdoshmëria buron nga kuadri ligjor i cili e ngarkon KLGJ me përgjegjësinë për hartimin e rregulloreve të ndryshme të cilat lidhen me magjistratin dhe statusin e tij, me të drejtat dhe detyrimet e tyre, pranimet dhe emërimet në ushtrim të detyrës, zhvillimin e karrierës, vlerësimin etik dhe professional, apo dhe përgjegjësinë disiplinore të tyre. Tre nga kompetencat e sipërpërmendura të KLGJ kanë lidhje me statusin e magjistratit dhe me zhvillimin e tij të karrierës ndaj ato i përkasin tërësisht fushës së veprimtarisë së KZHK-së.

Pasur parasysh, Synimin 1 të Strategjisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni pati prioritet përmbylljen sa më shpejt të kuadrit ligjor për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe në këtë mënyrë hapi procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve dhe juristeve te spikatur në të tri fushat e së drejtës, administrative, civile dhe penale, duke iu përgjigj edhe Rekomandimit nr. 1 të Rezolutës së Kuvendit për KLGJ-në.

Komisioni gjatë periudhës pesë vjeçare ka hartuar akte nënligjore dhe rregullave të brendshme që i kanë hapur rrugë procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit, procedurave te transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, procedurave të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, procedurave për verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, procedura për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë dhe Metodologjinë për Vlerësimin dhe Pikëzimin e Kandidatëve jo gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë, procedurave të lëvizjes paralele të gjyqtarëve,

hartimin e rregullave të detajuara për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, si dhe procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor etj. Gjithashtu, Komisioni ka hartuar dhe propozuar miratimin e shtesave në aktet nënligjore të miratuara duke i dhënë kështu zgjidhje nevojave emergjente të paraqitura në  gjykata të ndryshme.

Referuar tabelës me poshtë Komisioni përgjatë pesë viteve të veprimtarisë së tij ka propozuar dhe ka miratuar në total **1948** vendimmarrje.




## XIII. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024

### 1. Miratimi i akteve nënligjore

- Bazuar, në pikën 12, të nenit 52 të Ligjit për Statusin, KZHK do të duhet të hartojë dhe propozojë rregulla më të detajuara, që lidhen me ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës (shkalla e parë edhe apel).

### 2. Përfundimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve për një pozicion të lirë të shpallur përgjatë vitit 2022.

### 3. Përfundimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

- Përfundimi i procedurave të ngritjes në detyrë së kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën

Administrative të Apelit jo më vonë se 20 ditë, nga momenti i përfundimit të vlerësimeve etike dhe profesionale të gjithë kandidatëve për çdo pozicion të lirë.

**4. Hapja e procedurave të reja lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të përcaktuara si gjykata në nevojë.**

**5. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për caktimin e kuotave për magjistratë dhe ndihmës ligjorë për vitin akademik 2024-2025**

- Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 29, të Ligjit për Statusin në janar të çdo viti, Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë (profili gjyqtar) që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik. Krahas kësaj, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 53, të Ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë edhe numrin maksimal të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

**6. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për verifikimin me prioritet të kandidaturave, të cilat mund të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2024-2025 si dhe emërimin e magjistratëve që do të përfundojnë Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024.**

- Referuar përcaktimit ligjor, të bërë në pikën 5, neni 262 të Ligjit 115/2016, që parashikon se: "*Viti akademik hapet të hënën e parë të muajit tetor dhe mbaron jo më vonë se fundi i korrikut të vitit pasardhës",* Këshilli në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës do të duhet të fillojë në kohë dhe të verifikojë me prioritet kandidatët, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2024-2025, me qëllim që të hënën e parë të tetorit 2024 të gjithë kandidatët fitues të kualifikuar të fillojnë procesin mësimor rregullisht.

**7. Trajtimin në kohë të kërkesave të ardhura nga gjykatat ku do të kërkohet caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta, në kushtet kur nëpër gjykata vijon krijimi i vakancave për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj gjyqtarëve.**

**8. Bashkëpunimi me institucionet e sistemit të drejtësisë nëpërmjet mekanizmit të komandimit të gjyqtarëve në funksion të mirëfunksionimit të këtyre institucioneve.**

**9. Trajtimin në kohë të kërkesave të ardhura nga gjyqtarët apo gjykatat e ndryshme që lidhen me çështje të karrierës gjyqësore.**

Në përfundim me lejoni të falënderoj në mënyrë të veçantë për kontributin e pa çmuar në realizimin dhe konvertimin e 484 projekteve në vendimmarrje të Këshillit, të ish anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës z. Dritan Hallunaj, e znj. Marçela Shehu, si edhe një vlerësim të veçantë komponentëve të njësisë ligjore, Këshilltareve dhe të gjithë stafit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pa ndihmën e të cilëve nuk do të mund të përballohej një ngarkesë

e tillë. Kontributi impenjimi, s ‘forcues, sakrifikues i tyre ka mundësuar përballimin e sfidave të vështira me të cilën është përballuar sistemi i drejtësisë dhe përmbushja e detyrave tona Kushtetuese duke ruajtur në çdo rast qetësinë, pozitivitetin dhe frymën e bashkëpunimit.